

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Separol® W-320

DISARMANT EKONOMIK ME BAZË UJI

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Separol® W-320 është një disarmant gati për përdorim dhe pa tretës. Është një emulsion me bazë vaji mineral të rafinuar.

PËRDORIMET

Sika® Separol® W-320 mund të aplikohet në kantier ose në fabrika parafabrikatesh.

Është krijuar veçanërisht për përdorime në:

- Betoforma të lëmuara joabsorbuese
- Betoforma absorbuese
- Betoformë të nxehur (deri në +70°C)

Sika® Separol® W-320 është i përshtatshëm edhe për:

- Betoformë me teksturë

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

Sika® Separol® W-320 ka karakteristikat e mëposhtme:

- Viskozitet i ulët
- Aftësi e shkëlqyer “ngjitjeje” në sipërfaqet vertikale të betoformës
- I vetënivelueshëm pas aplikimit me spërkatje
- Eliminim i lartë i poreve
- Nuk krijon avuj të djegshëm
- Nuk krijon rrëshirë
- Redukton mbetjet e pluhurit në armaturë
- I sigurt për përdorim nga operatori

Ky produkt ofron avantazhet e mëposhtme:

- Ndarje e lehtë dhe e saktë e betoformës nga betoni i ngurtësuar
- Sipërfaqe përfundimtare me cilësi të lartë
- Nuk zvogëlon cilësinë e betonit në sipërfaqe
- Mbron betoformën nga korrodimi i hekurit dhe vjetrimi i shpejtë

MIRATIME / STANDARDE

Sika® Separol® W-320 është testuar në përputhje me procedurat e brendshme të testimit të Sika® - s.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Vajra mineralë të rafinuar, që mund të përzihen në ujë.
Ambalazhi	Kovë plastike: 20 lt Fuçi: 210 lt IBC: 1000 lt
Paraqitja / Ngjyra	Lëng, ngjyrë qumështi.
Jetëgjatësia	6 muaj nga data e prodhimit në ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar.
Kushtet e magazinimit	Të mbrohet nga ngrica, rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe kontaminimi. Mbylleni ambalazhin që është përdorur.
Dendësia	0.97 g/cm ³ (në +20°C).

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi

Sika® Separol® W-320 jep efikasitet, në varësi të rrethave të aplikimit dhe betoformës së përdorur, prej deri në ~ 140 m²/kg për betoformë joabsorbuese (p.sh. çelik ose plastik).

Temperatura e mjedisit

+5°C min. / +50°C max.

UDHËZIME APLIKIMI

APLIKIMI

Përpara aplikimit Sika® Separol® W-320 duhet të përzihet plotësisht.

Sika® Separol® W-320 është gati për përdorim. Mos e treni apo përzieni me materiale të tjera!

Betoformat duhet të jenë të thata dhe të pastra.

Çdo mbetje ndryshku dhe betoni duhet të hiqet.

Sika® Separol® W-320 aplikohet në shtresa të holla, të njëtrajtshme me paraqitje me pika të lehta e të bardha, që mbulon të gjithë sipërfaqen (në rastet e armaturave shumë thithëse, mund të nevojitet një aplikim shtesë).

Rekomandojmë përdorimin e një pistolette për spërkatje me presion 3-6 bar dhe kokë të sheshtë spërkatjeje (01 F 110 p.sh. 652.307 ose 652.245). Grumbullimet e Sika® Separol® W-320 duhet të shmagen. Çdo sasi shtesë duhet të fshihet me një copë ose sfungjer.

Pas aplikimit, duhet të vrojtohet një kohë avullimi prej 20 minutash në +20°C.

Përpara hedhjes së betonit rekomandohet të kryhen teste paraprake në mënyrë që të optimizohet procedura për çdo projekt.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Separol® W-320

Mars 2019, Botimi 01.01

021405021000000160

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaSeparolW-320-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf